

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË

Departamenti për të Drejtat e Njeriut, Decentralizim dhe
Komunitete, Sektori i Qeverisjes së Mirë

Raporti mbi Implementimin e Ligjit për Qasje në
Dokumente Zyrtare në Nivelin Komunal

Nëntor 2007

PËRMBAJTJA

Përmbledhje Ekzekutive	3
A. Hyrje	5
B. Liria e informimit	5
1. <i>Rëndësia dhe qëllimi i legjislacionit mbi lirinë e informimit</i>	5
a) Ligji mbi qasjen në dokumentet zyrtare	6
b) Legjislacioni përcjellës për implementimin e Ligjit mbi Qasje në Dokumente Zyrtare.....	7
c) Standardet për Kosovën	8
C) Implementimi i kornizës ligjore	8
1. <i>Ligji mbi Qasje në Dokumente Zyrtare</i>	8
a) Vetëdijesimi	8
b) Regjistri	9
c) Raporti vjetor	9
2. <i>Udhëzimi Administrativ 2006/03 për implementimin e ligjit</i>	10
a) Vetëdijesimi	10
b) Zyra e Arkivës/Arkivisti.....	11
c) Skema e klasifikimit	12
d) Komunikimi me banorët.....	13
3. <i>Plani i Veprimit për implementimin e Udhëzimit Administrativ 2006/03</i>	13
a) Vetëdijesimi	13
b) Aktivitetet e ndërmarra.....	13
c) Lista e dokumenteve të ndjeshme komunale	14
d) Shembuj të dokumenteve të ndjeshme komunale.....	15
D. Aktivitetet e trajnimit/të ngritjes së vetëdijes	16
1) Trajnimi/Instituti Kosovar për Administratë Publike	16
2) Doracaku i Ministrisë për Shërbime Publike.....	17
3) Aktivitetet komunale për ngritje të vetëdijes mbi ligjin	18
E. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare	18
1) Numri i kërkesave të pranuar/qasjes së lejuar apo të refuzuar	19
2) Baza e të dhënave mbi numrin e kërkesave.....	19
F. Konkluzionet	20
G. Rekomandimet	21

Përmbledhje Ekzekutive

Qeverisja funksionale dhe e përgjegjshme njihen si qëllime të rëndësishme në të gjitha shtetet demokratike në Evropë. Qeverisja e mirë lokale nuk ka të bëjë vetëm me ofrimin e shërbimeve publike, por edhe me mbrojtjen e lirive të banorëve lokal, me krijimin e hapësirës për pjesëmarrje demokratike, duke respektuar parimet e transparencës së institucioneve dhe sundimit të ligjit. Në këtë aspekt, komunat duhet ta avancojnë transparencën dhe implementimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare, për t'u përkujdesur që kërkesat për informata të shqyrtohen në mënyrë efektive.¹

Ky raport ofron një pasqyrë të implementimit të ligjit dhe akteve nën-ligjore për implementimin e tij në nivel komunal. Ky raport paraqet rezultatin e anketës së paradokohshme të ndërmarrë nga Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE), Departamenti për të Drejtat e Njeriut, Decentralizim dhe Komunitete, përmes Sekcionit të tij për Qeverisje të Mirë Lokale.

Pas hyrjes në Pjesën A, Pjesa B e raportit vë në pah rëndësinë e legjislacionit për lirinë e informimit si dhe të kornizës së aplikueshme ligjore e cila shtjellon të drejtat e banorëve të Kosovës për t'iu qasur informatave. Pjesa pasuese C analizon nivelin e implementimit të ligjit si dhe legjislacionit përcjellës në nivel lokal. Kjo pjesë po ashtu prezanton aspektin e vetëdijes së zyrtarëve komunal lidhur me ligjet në fuqi përkritazi me lirinë e informimit në Kosovë, përfshirë edhe shkallën e përmbyshjes së tyre nga komunat lidhur me çështjet siç janë: krijimi i regjistrave; raportimi; emërimi i zyrtarit të arkivave për t'u ballafaquar me kërkesat; klasifikimi i dokumenteve; si dhe komunikimi me banorët. Pjesët D dhe E prezantojnë aktivitetet në ngritjen e vetëdijes në komuna rreth zbatimit të Ligjit si dhe të dhëna mbi numrin e kërkesave për qasje në dokumentet zyrtare që u janë parashtruar komunave ndërmjet viteve 2006 – 2007. Ky raport përfundon me një listë të rekomandimeve.

Të dhënat janë grumbulluar nga Ekipet Komunale të OSBE-së në mbarë Kosovën në periudhën ndërmjet majit dhe qershorit duke përfshirë edhe disa të dhëna pasuese në muajin gusht. Analiza tregon se zyrtarët komunal, në përgjithësi janë në dijeni të ligjit. Në të shumtën e rasteve, zyrtarët komunal kanë edhe njohuri themelore mbi ligjin dhe obligimet që rrjedhin nga ai. Aktivitetet e trajnimit si dhe ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunal lidhur me ligjit po ashtu kanë shënuar rritje.

Mirëpo, vlerësimi po ashtu vë në dukje se një numër i madh i zyrtarëve komunal nuk kanë njohuri thelbësore për ligjin posaçërisht për legjislacionin përcjellës për implementimin e ligjit. Gjithashtu, nuk ka procedurë të harmonizuar lidhur me klasifikimin e dokumenteve të ndjeshme. Edhe pse formalisht ekziston një udhëzim administrativ i cili e rregullon këtë çështje, ai nuk zbatohet në praktikë. Për të adresuar këtë çështje, OSBE-ja rekomandon vendosjen e një bashkëpunimi më të ngushtë ndërmjet nivelit qendror dhe lokal, lidhur me klasifikimin e dokumenteve të ndjeshme si dhe vazhdimin dhe rritjen e numrit të aktiviteteve në ngritjen e vetëdijes.

¹ Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/23, Mbi Shpalljen e Ligjit e miratuar nga Kuvendi i Kosovës mbi Qasjen në Dokumentet Zyrtare, të 6 nëntorit 2003.

Raporti po ashtu prezanton të dhëna lidhur me numrin e kërkesave që i janë parashtruar komunave, përfshirë edhe numrin e rasteve ku qasja është lejuar apo mohuar. Rezultatet tregojnë se numri i kërkesave është ende shumë i ulët në pjesën më të madhe të komunave. Numri i vogël i kërkesave nënkupton se banorët nuk janë të njoftuar për të drejtat e tyre sipas ligjit. Në këtë aspekt, OSBE-ja rekomandon që komunat të organizojnë fushata vetëdijesimi për banorët e tyre dhe t'i informojnë ata mbi të drejtën e qasjes në dokumentet zyrtare.

A. Hyrje

Misioni i OSBE-së në Kosovë kryen aktivitete në mbështetjen dhe avancimin e parimeve të qeverisjes së mirë në komuna në mbarë Kosovën. Në kuadër të OSBE-së, Sekcioni për Qeverisje të Mirë Lokale synon të vlerësojë nëse është miratuar korniza e përgjithshme juridike që mbështet qeverisjen e mirë lokale në Kosovë dhe përputhshmërinë e saj me normat dhe standardet relevante. Njëkohësisht, Sekcioni për Qeverisje të Mirë Lokale merret edhe me avancimin dhe mbështetjen e transparencës komunale në raport me implementimin e ligjit.

Qëllimi i këtij raporti është të hulumtojë situatën aktuale lidhur me implementimin e ligjit në nivel komunal me qëllim të identifikimit të mangësive dhe sferave të mundshme për përmirësim, për t'i ndihmuar krijimit të një qeverisjeje më efektive dhe më transparente në nivel lokal dhe arritjen e respektimit të së drejtës individuale për qasje në informata zyrtare. Raporti shqyrton çështjet siç janë: njohuria e zyrtarëve komunal lidhur me ligjin dhe përmbushjen e obligimeve të parashikuara nga ligji dhe legjislacioni përcjellës nga komunat. Raporti po ashtu shqyrton nevojat e ngritjes së kapaciteteve të zyrtarëve komunal në përgjithësi, dhe atyre që merren drejtpërsëdrejti me kërkesat për informata zyrtare në veçanti.

Baza e këtij raporti përbëhet nga të dhënat e mbledhura dhe informatat e siguruar nga Ekipet Komunale të OSBE-së, ku është vlerësuar situata në të gjitha 30 komunat e Kosovës dhe në tre pilot njësi komunale (Mamushë, Junik dhe Hani i Elezit).² Këto Ekiye Komunale kanë shkëmbyer përvojat e tyre të punës së përditshme dhe kanë kryer intervista gjysmë të strukturuar me zyrtarët komunal dhe grupet e tjera të interesit. Sekcioni për Qeverisje të Mirë Lokale analizoi rezultatet nga terreni në mënyrë që ta kuptojë nivelin e implementimit të legjislacionit mbi lirinë e informimit në nivel komunal, dhe me qëllim të identifikimit të pengesave dhe problemeve në të cilat është hasur gjatë procesit të implementimit.

Raporti i është dedikuar popullatës së përgjithshme, Institucioneve të Përkohshme të Vetë-qeverisjes, zyrtarëve komunal, Misionit të Përkohshëm Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), komunitetit të donatorëve, si dhe organizatave ndërkombëtare dhe joqeveritare. Ai synon të shërbejë si një vegël për t'ju ndihmuar të gjithë akterëve të kyçur në reformën e qeverisjes lokale.

B. Liria e informimit

Ky kapitull shkurtimisht prezanton rëndësinë dhe pikësynimet kryesore të legjislacionit për lirinë e informimit në përgjithësi. Ai po ashtu përqëndrohet në kornizën specifike ligjore mbi lirinë e informimit e cila është në fuqi në Kosovë.

1. Rëndësia dhe qëllimi i legjislacionit mbi lirinë e informimit

Në vitin 1946 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, gjatë miratimit të njëres prej rezolutave të para të saj, i referohet lirisë së informimit:

² Vlerësimi është kryer gjatë periudhës maj dhe qershor 2007, me aktivitete përcjellëse në gusht 2007.

“...Liria e informimit është një e drejtë themelore e njeriut dhe është një gurthemel i të gjitha lirive të cilat janë të shenjta për Kombet e Bashkuara”,³

Ky citat i hershëm i Asamblesë së Përgjithshme tregon rëndësinë thelbësore që ishte dhe mbetet e ndërlidhur me lirinë e informimit. Bazohet në pikëpamjen se informatat të cilat mbahen tek institucionet publike janë informata publike. Organi publik është vetëm kujdestari i përkohshëm i informatave të tilla.

Informatat për qeverinë qendrore dhe lokale janë me rëndësi thelbësore nëse popullata duhet ta marrë një vendim të informuar – siç janë zgjedhjet – por po ashtu edhe për shumë situata të tjera ku ushtrohet e drejta demokratike. Për këtë arsye, transparenca dhe llogaridhënia institucionale, si komponente të rëndësishme të qeverisjes së mirë, janë pikësnyime kryesore të akteve mbi lirinë e informimit. Këto dy pikësnyime mund të arrihen më së miri përmes miratimit të legjislacionit specifik mbi lirinë e informimit. Rreth shtatëdhjetë shtete në mbarë botën, përfshirë edhe shtetet e regjionit të Ballkanit, kanë implementuar disa forma të legjislacionit mbi lirinë e informimit.⁴ Këto ligje rregullisht krijojnë një sistem për të mundësuar qasjen në informata apo shënime të cilat mbahen nga organet qeveritare.

Parimi kryesor në shumicën e legjislacioneve mbi lirinë e lëvizjes është se barra e dëshmisë bie mbi organin nga i cili *janë kërkuar* informatat. Me fjalë të tjera, kërkuesi nuk ka nevojë të ofrojë shpjegime për kërkesën e tij, por nëse informata nuk shpaloset, duhet të ofrohen arsye valide. Së fundi, e drejta për t’iu qasur informatave është e paraparë në Nenin 10 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut.⁵

2. Korniza ligjore dhe politike në Kosovë

a) Ligji mbi qasjen në dokumentet zyrtare

Rregullorja e UNMIK-ut 2003/32 mbi shpalljen e Ligjit për Qasje në Dokumentet Zyrtare, parasheh një procedurë gjithëpërfshirëse dhe të unifikuar për qasje në dokumente zyrtare të cilat janë në pronësi, janë përgatitur apo ruhen nga institucionet në Kosovë, përfshirë edhe komunat dhe agjencionet e tyre. Ligji përcakton rregullën sipas të cilit të gjitha dokumentet zyrtare duhet të jenë në dispozicion për qasje dhe prezanton një listë të përjashtimeve.⁶ Ky rregull po ashtu mbrohet nga Neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila shprehimisht cek interesat të cilat mund të arsyetojnë refuzimin e qasjes në dokumentet zyrtare. Sipas kësaj, personat ka të drejtë qasjeje në dokumente zyrtare sipas ligjit vendor dhe kjo qasje mund të nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve dhe kushteve të cilat parashikohen me ligj dhe të

³ Asambleja e Përgjithshme 59 (I), séanca e 65 plenare, 14 dhjetor.

⁴ Më i vjetri është Akti mbi Lirinë e Shtypit në Suedi i vitit 1766.

⁵ *Liria e të shprehurit dhe liria e marrjes së informatave* në rastin *Leander v. Sweden* (26 mars 1987, Seria A no. 116, f 29 paragr. 74 dhe 75). Në këtë rast, edhe pse Gjykata nuk e pranoi ndërhyrjen e autoriteteve qeveritare në të drejtën e kërkuesve të pranojnë informata, Gjykata arrin në përfundim se liria e pranimit të informatave mbrohet nga Neni 10 i ECHR.

⁶ Pjesët 3.1 dhe 4 të LQDZ.

cilat janë të domosdoshme për mbrojtjen e interesave të cekura në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.⁷

Ligji definon procedimin e kërkesave, periudhën kohore brenda së cilës institucionet duhet t'i përgjigjen kërkesës së parashtruesit, si dhe mënyrat se si mund të vlerësohen dokumentet zyrtare.⁸ Për më tepër, Ligji i definon përfituesit e së drejtës në qasje të dokumenteve zyrtare dhe cek interesat publike për të cilat mund të bëhet përjashtim në rregullin e qasjes në dokumente zyrtare. Si duhet të trajtohen dokumentet zyrtare shtjellohet në Kapitullin II, ndërsa Kapitulli III i ligjit i referohet krijimit të listave të dokumenteve zyrtare të cilat mbahen nga institucionet. Ligji po ashtu përmban dispozitat mbi përdorimin e gjuhës, krijimin e Komisionit Ndër-institucional për shqyrtimin e praktikave më të mira mbi qasjen në dokumentet zyrtare, si dhe obligimin e institucioneve dhe Qeverisë për të lëshuar raporte vjetore.

b) Legjislacioni përcjellës për implementimin e Ligjit mbi Qasje në Dokumente Zyrtare

Në procesin e implementimit të LQDZ-së, Ministria e Shërbimeve Publike dhe Qeveria kanë miratuar legjislacionin përcjellës. Udhëzimi Administrativ 2006/03 mbi implementimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare, i lëshuar nga Ministria e Shërbimeve Publike, rregullon çështjet siç janë listat e dokumenteve zyrtare, krijimin e listave të dokumenteve të ndjeshme si dhe çështjet e tjera të ndërlidhura.

Po ashtu, Ministria e Shërbimeve Publike ka lëshuar Udhëzimin Administrativ 2006/01⁹ i cili përcakton formularët e kërkesave si dhe formularët për qasje në të dhëna kompjuterike.¹⁰ Lidhur me formën e parashikuar nga ky udhëzim administrativ, dhe përkundër qëllimeve të mira të Ministria e Shërbimeve Publike për të lehtësuar implementimin e ligjit, është me rëndësi të përmendet se qytetarët nuk janë të obliguar të plotësojnë ndonjë formular kur parashtrorin kërkesë për qasje në informata. Neni 5 i ligjit qartazi lejon përdorimin e çfarëdo forme të shkruar apo elektronike gjatë kërimit të qasjes në dokumente zyrtare.

Akti më i fundit nën-ligjor për implementimin e ligjit është Udhëzimi Administrativ 07/2007 mbi Parimet, Procedurat dhe Shenjat e Klasifikimit të Dokumenteve Zyrtare, i lëshuar nga Zyra e Kryeministrit. Ky udhëzim administrativ përcakton parimet për klasifikimin e dokumenteve zyrtare dhe parashih krijimin e Komisionit në çdo Institut, që është përgjegjës për përpilimin dhe miratimin e listës së dokumenteve të ndjeshme. Pasi që udhëzimi administrativ është lëshuar në qershor të këtij viti, implementimi i tij ende nuk ka filluar. Shpresohet se ai do të ndihmojë në harmonizimin e procesit të klasifikimit të dokumenteve të ndjeshme që është dashur të kryhet që moti.

⁷ Interesat e cekura në Nenin 10, paragrafi 2 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut “[...] interesat e sigurisë kombëtare, integritetit territorial apo sigurisë publike, parandalimin e trazirave apo krimin, mbrojtja e shëndetit apo moralit, mbrojtja e të drejtave apo reputacionit të të tjerëve, për të parandaluar shpallorin e informatave të pranuar në besim, ose për ruajtjen e autoritetit dhe paanshmërisë së sistemit gjyqësor.”

⁸ Pjesa 5, 7 dhe 9 ligjit.

⁹ Udhëzimi Administrativ 2006/1 për implementimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare, Shtojca 1 Formulari i kërkesës për Qasje në Dokumentet Zyrtare, si dhe Shtojca 2 Formulari për Qasje dhe të Drejtat e Shfrytëzimit të Sistemit Kompjuterik.

¹⁰ Udhëzimi Administrativ 2006/01, Shtojca 1 dhe 2, për Formularët e Kërkesës dhe Formulari për Qasje të Dhënave Kompjuterike.

c) Standardet për Kosovën

Krijimi i institucioneve funksionale demokratike në Kosovë, përfaqëson njërin prej prioriteteve të parashikuara me kornizën e Standardeve për Kosovën.¹¹ Standardi i parë ka të bëjë me institucionet demokratike. Njëri prej treguesve është liria e informimit e cila parashikohet me Planin për implementimin e Standardeve.¹² Për monitorimin dhe raportimin e implementimit të këtij Standardi, është krijuar një Grup Punues për Funksionimin e Institucioneve Demokratike, i cili kryesohet nga MSHP-ja dhe bashkë-kryesohet nga OSBE-ja. Grupi Punues takohet rregullisht dhe vlerëson përparimin e bërë në krijimin e institucioneve demokratike përfshirë implementimin e ligjit.¹³

C) Implementimi i kornizës ligjore

Kapitulli vijues prezanton situatën aktuale të implementimit të kornizës ligjore për qasje në dokumente zyrtare në të 30 komunat dhe në tre pilot njësitë komunale.. Në këtë kapitull po ashtu prezantohen aspektet e ndryshme të zbatimit të Ligjit dhe të legjisllacionit përcjellës.

1. Ligji mbi Qasje në Dokumente Zyrtare

a) Vetëdijesimi

Ligji vë në zbatim koncepte plotësisht të reja për sistemin administrativ të Kosovës dhe për shoqërinë në përgjithësi. Ky është ligji i parë në Kosovë që garanton të drejtat e banorëve që t'iu qasur informatave zyrtare që mbahen nga organet qeveritare dhe nga institucionet tjera. Ligji i ri has në një traditë të mos-shpalosjes së informatave publike si rezultat i një qasjeje kufizuese ndaj transparencës në vitet e mëhershme. Prandaj, aktivitetet në ngritjen e vetëdijes përbëjnë një element shumë të rëndësishëm në zbatimin e transparencës së mëtejme në administratën publike dhe për vetë zbatimin e Ligjit.

Neni 13 i Ligjit parashef obligimin e institucioneve të ndërmarrin masa të caktuara për të informuar popullatën lidhur me të drejtën që gëzojnë sipas këtij ligji. Sipas vlerësimit tonë në komuna, vetëm një komunë ka deklaruar se nuk është e njoftuar me çështjen e lirisë së informimit dhe në veçanti për ekzistimin e Ligjit. Mirëpo, edhe në mesin e komunave që janë përgjigjur pozitivisht në çështjen e njohurisë, niveli i njohurive ndryshon. Në gjashtë komuna, edhe pse zyrtarët komunal kanë vërtetuar se janë në dijeni të ekzistimit të Ligjit, ata po ashtu theksuan se nuk kanë njohuri të plotë

¹¹ Standardet për Kosovën janë lansuar nga UNMIK-u dhe Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes më 10 dhjetor 2003. Standardet për Kosovën janë një tërësi e caqeve që Kosova duhet t'i plotësojë në mënyrë që të arrijë pajtueshmëri të plotë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999) dhe me rregulloren e UNMIK-ut 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetë-qeverisje të Përkohshme në Kosovë, e 15 majit 2001.

¹² Dokumenti përshkruan veprimet konkrete që duhet të ndërmerren në mënyrë që të plotësohen Standardet. Ky plan është dakorduar dhe finalizuar ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe UNMIK-ut më 31 mars 2004 dhe rrjedhimisht pranuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së në deklaratën e tij të 12 dhjetorit 2003.

¹³ Çdo tre muaj, Qeveria e Kosovës dhe UNMIK-u bëjnë "vlerësimin rresht për rresht" të veprimeve të ndërmarra si pjesë e Planit për Implementimin e Standardeve të Kosovës. Në këtë vlerësim, përdoren tregues të posaçëm për të vlerësuar nëse këto veprime kanë rezultuar në plotësimin e Standardeve. Kjo më pastaj rezulton me raport të quajtur Vlerësimi Teknik, i përpiluar nga UNMIK-u në përputhje me Qeverinë e Kosovës.

të legjislacionit mbi lirinë e informimit që është në fuqi në Kosovë. Për më tepër, të paktën në dy raste, zyrtarët kanë deklaruar se me ligj janë të njoftuar Kryeshefi Ekzekutiv, Drejtorët e Departamenteve dhe Zyrtarët Ligjor, por jo edhe pjesa tjetër e shërbyesve civil.¹⁴

Disa komuna theksuan rëndësinë e aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes dhe trajnimin të cilët ishin organizuar nga niveli qendror, në rritjen e rëndësisë së transparencës në nivel komunal. Lidhur me këtë, komunat e Podujevës dhe Skenderajt përmendën një fushatë vetëdijesimi mbi ligjin të organizuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

b) Regjistri

Neni 10.3 e ligjit parasheh krijimin e një regjistri të dokumenteve të cilat mbahen dhe janë në pronësi të institucioneve, ndërsa “institucionet duhet menjëherë të ndërmarrin masa për përgatitjen e regjistrit [...]”

Sipas vlerësimit, vetëm dhjetë nga 33 komunat dhe pilot njesi komunale të e intervistuar kanë konfirmuar plotësimin e obligimeve të përpilimit të një regjistri të tillë. Zyrtarët komunal në 23 komunat e tjera kanë deklaruar se nuk kanë një regjistër të tillë të dokumenteve zyrtare, edhe pse gjashtë kanë deklaruar se janë në proces të përpilimit të tij.¹⁵ Një komunë ka cekur se, nuk e posedojnë një dokument të unifikuar të dokumenteve zyrtare, por çdo departament ka regjistrin e vet.¹⁶ Në një rast tjetër, zyrtarët nga komunat i janë referuar librit të protokolit i cili përmban informata thelbësore për çdo dokument zyrtar, mirëpo kjo listë nuk pasqyron “një përshkrim të shkurtër të përmbajtjes së dokumentit” ashtu siç është paraparë në Nenin 10.2 të ligjit.

c) Raporti vjetor

Raporti përmban një dispozitë e cila i obligon institucionet të lëshojnë raporte vjetore. Ky raport do të duhej të përfshinte numrin e rasteve të cilave institucionet ua kanë refuzuar qasjen, arsyet për refuzimin si dhe numrin e dokumenteve të ndjeshme që nuk janë përfshirë në regjistër.¹⁷

Sa i përket raportimit, vetëm dy komuna kanë deklaruar se kanë lëshuar raporte të tilla.¹⁸ Njëra prej këtyre iu referua një raportit ku jepej numri i kërkesave të pranuar, ato që janë shqyrtuar dhe ato të cilat momentalisht shqyrtohen. Në këtë mënyrë, raporti përmban informata të cilat janë parashikuar me ligjin e aplikueshëm.¹⁹ Në komunën e dytë, edhe pse zyrtarët komunal konfirmuan se raporti përdoret, ata nuk përmendën informata specifike që përfshihen në to.²⁰ 31 komunat e mbetura ose pilot njesi komunale nuk kanë lëshuar raporte të tilla. Në kuadër të këtij numri, tri komuna kanë deklaruar se edhe pse nuk kanë lëshuar raporte specifike mbi implementimin e ligjit, informatat mbi rastet e proceduara nga komunat janë përfshirë në raportet e tjera, siç janë vlerësimet e rregullta të Implementimit të Standardeve.²¹ Në anën tjetër

¹⁴ Podujevë dhe Lipjan.

¹⁵ Shtërpcë, Viti, Ferizaj, Novobërdë, Shtime dhe Mitrovicë.

¹⁶ Istog.

¹⁷ Pjesa 16.1 e ligjit.

¹⁸ Gjakovë dhe Dragash.

¹⁹ Pjesa 16 e ligjit.

²⁰ Gjakovë.

²¹ Podujevë, Obiliq dhe Novobërdë.

në disa raste komunat kanë deklaruar se raporti vjetor, i cili dërgohet në Drejtoratin Komunal të Administratës së Përgjithshme, përfshihet një pjesë që ka të bëjë me implementimin e ligjit, gjegjësisht – numrin e kërkesave që i janë parashtruar komunës për qasje në dokumentet zyrtare.²²

Një prej arsyeve që jepen nga komunat për mos-lëshimin e raporteve vjetore është numri i pakët madje edhe mungesa e plotë e kërkesave të parashtruara.²³ Arsyet e tjera janë mungesa e punëtorëve dhe mungesa e njohurisë mbi ligjin, ndërsa në dy raste zyrtarët komunal thanë se zbatimi i ligjit nuk konsiderohet prioritet i madh i komunës.²⁴ Një komunë ka deklaruar se ligji implementohet që nga fundi i vitit të kaluar, prandaj raporti i parë mbi zbatimin e këtij ligji do të lëshohet në fund të këtij viti.²⁵

2. Udhëzimi Administrativ 2006/03 për implementimin e ligjit

a) Vetëdijesimi

Udhëzimi Administrativ 2006/03 për implementimin e ligjit i miratuar nga Ministria e Shërbimeve Publike, është një akt nën-ligjor gjithëpërfshirës dhe i detajizuar i cili parashihet rregulla të caktuara për implementimin e ligjit. Aty përfshihen çështje siç janë emërimi i arkivistit, skema e klasifikimit, funksionet e Komisionit Ndër-Institucional për vlerësimin e praktikave administrative, komunikimin me banorë, e kështu me radhë.

Lidhur me vetëdijesimin e komunave lidhur me Udhëzimi Administrativ 2006/03, gjashtë komuna kanë deklaruar se nuk kanë dijeni për UA²⁶ ndërsa në tre komuna UA është i njohur vetëm për disa zyrtarë komunal.²⁷ Ngjashëm me ligjin të analizuar sipër, në shumë raste ata që pohuan se janë në dijeni me udhëzimin administrativ po ashtu shtuan se nuk kanë njohuri substanciale lidhur me të.. Një komunë ka deklaruar se Zyrtari Komunal për Informim dhe Zyrtarët Ligjor janë të njoftuar me udhëzimin administrativ por jo edhe arkivisti, edhe pse pjesë të mëdha të udhëzimit administrativ përcaktojnë detyrat dhe procedurat që duhet të zbatohen nga vetë arkivisti.²⁸ Në një rast tjetër, Drejtorët e Departamenteve raportuan se janë në dijeni për AU por shërbyesit civil nuk janë në dijeni për rregullat praktike.²⁹ Përkundër kësaj, në disa komuna³⁰ zyrtarët shfaqën njohuri mjaft të gjerë të udhëzimit administrativ, të cilën ata e përmendën si bazë për përpilimin e Planit të Veprimit për Transparencën Komunale.³¹ Përveç kësaj, një komunë ka përmendur se disa nga zyrtarët e saj kanë marrë trajnim specifik mbi ligjin dhe mbi Udhëzimin Administrativ 2006/03.³²

²² Kaçanik, Viti dhe Mitrovicë.

²³ Zubin Potok, Laposaviq, Vushtrri, Gjilan, Lipjan, Shtime, Malishevë dhe Istog.

²⁴ Zveçan dhe Mamushë. Zyrtarët komunal në Zveçan po ashtu theksuan se mungesa e bashkëpunimit ndërmjet komunës dhe Institucioneve të Përkohëshme të Vetëqeverisjes-së i bën këso raporte të padobishme.

²⁵ Prishtinë.

²⁶ Dragash, Prizren, Shtërpçë, Viti, Laposaviq dhe Vushtrri

²⁷ Malishevë, Pejë dhe Kaçanik/Kaçanik.

²⁸ Fushë Kosovë.

²⁹ Lipjan.

³⁰ Obiliq dhe Klinë.

³¹ Bazuar në Udhëzimin Administrativ 2006/03 mbi Transparencën Komunale, të lëshuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, çdo komunë duhet të përpilojë Planin e vet Komunal të Veprimit për Transparencë.

³² Hani i Elezit.

b) Zyra e Arkivës/Arkivisti

Udhëzimi Administrativ 2006/03 parasheh se çdo institucion duhet të ketë një zyrë të arkivës, e cila ndër detyrat e tjera, do të merret me kërkesa për qasje në dokumentet zyrtare.³³ Ky udhëzim po ashtu parasheh emërimin e një arkivisti i cili do të mundësojë qasje në dokumente zyrtare në përputhje me ligjin.³⁴

Vlerësimi tregon se 18 komuna kanë raportuar se kanë themeluar zyrën e arkivës ndërsa 15 të tjera jo. Mirëpo, prej komunave që kanë zyre të arkivës, shumica prej tyre iu referoheshin zyrave të arkivës që ishin themeluar para miratimit të Udhëzimit Administrativ 2006/03. Edhe pse dy komunat shprehimisht kanë deklaruar se i kanë themeluar arkivat në përputhje me Nenin 15 të udhëzimit administrativ,³⁵ komunat e tjera duket se iu referoheshin zyrave të arkivave të cilat u shërbejnë banorëve në përgjithësi dhe të cilët janë themeluar në përputhje me Ligjin mbi Arkivat.³⁶ Në ato komuna ku zyrat e arkivave nuk ekzistojnë, komunat kanë gjetur një zgjidhje alternative. Për shembull, katër komuna të intervistuar kanë cekur se Zyra e Pranimit ose Sporteli shfrytëzohet si një “zyrë e arkivës”.³⁷ Në një rast tjetër, zyrtarët komunal kanë deklaruar se drejtorati komunal i administratës së përgjithshme aktualisht vepron si një nikoqir i zyrës së arkivës,³⁸ ndërsa në një komunë zyra ligjore e komunës shërben si arkivë komunale.³⁹

OSBE-ja beson se edhe pse këto stabilimente nuk i plotësojnë kushtet për arkivim të duhur ashtu siç parashihet me ligjin në fuqi, këto zgjidhje alternative, nëse përdoren si zgjidhje e përkohshme, mund të jenë efektive posaçërisht në procedimin e kërkesave për qasje të informatave zyrtare.

Lidhur me emërimin e arkivistit në 11 komuna, zyrtarët kanë raportuar se kanë emëruar një arkivist i cili po ashtu merret me shtjellimin e kërkesave. Komunat tjera kanë deklaruar se nuk kanë një arkivist me detyrë specifike të merituar, me këto kërkesa, por kërkesat shtjellohen nga zyrtarë të tjerë komunal. Zyrtari në Zyrën e Pranimit shpesh përmendet si një person i cili i shtjellon kërkesat.⁴⁰ Ndër zyrtarë të tjerë komunal të cilët kanë deklaruar se janë përgjegjës për t'i shtjelluar kërkesat përfshihen: ofiqarët komunal, shefi i arkivës, zyrtarët e regjistrimit civil, qendra për shërbime të qytetarëve dhe sekretarët e pilot njesive komunale..

Edhe pse kjo nuk është e ndërlidhur me emërimet e arkivistit, është me rëndësi të përmendet se një zyrtar komunal ka deklaruar se arkivisti i cili është emëruar të merret me kërkesat e qytetarëve për qasje në dokumente zyrtare po ashtu është autorizuar të kërkojë nga parashtruesit e kërkesave 1 euro pagesë për këtë shërbim.⁴¹

³³ Neni 15 i Udhëzimit Administrative 2006/03: “Çdo institucion duhet të ketë një zyrë të arkivës së institucionit” dhe Neni 15.1: “Në institucione ku nuk është i arsyeshëm ekzistimi i një zyreje, funksionet e zyrës së arkivit, arkivistit si dhe punëtorëve të arkivës mund të ushtrohen nga ndonjë zyrë tjetër dhe nga një zyrtar i autorizuar për këtë punë nga një menaxher më i lartë institucional.”

³⁴ Neni 17 i Udhëzimit Administrativ 2006/03.

³⁵ Klinë dhe Fushë Kosovë.

³⁶ Rregullorja e UNMIK-ut 2003/20 mbi Shpalljen e Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës mbi Materialin Arkivor dhe Arkivat, te 23 qershorit 2003.

³⁷ Kamenicë, Mamushë, Mitrovicë dhe Prishtinë.

³⁸ Pejë.

³⁹ Gjilan.

⁴⁰ Klinë, Deçan, Istog, Ferizaj, Obiliq, Prishtinë, Shtime dhe Mitrovicë.

⁴¹ Fushë Kosovë.

Në një komunë tjetër, kjo taksë është 2 euro për faqe, ndërsa arkiva komunale nuk pranon kërkesa për qasje në dokumente zyrtare përmes postës.⁴² Në të dy rastet, komunat mund të jenë në kundërshtim me disa dispozita të ligjit. Neni 9. i ligjit parasheh që taksat e cila mund të kërkohej “nuk duhet të tejkalojë koston e vërtetë të përgatitjes dhe dërgimit të kopjeve [...]”. Për më tepër, kjo dispozitë shprehimisht deklaron se kopjet prej më pak se 20 faqeve të formatit A4 janë pa pagesë. Së këndejmi, një shumë paushall mund të kërkohej për kopjet prej më shumë se 20 faqeve të formatit A4 dhe nuk duhet t’i tejkalojë kostot reale të përgatitjes dhe dërgimit. Së fundi, Neni 5.1 i ligjit shprehimisht lejon parashtrimin e kërkesave për qasje të ndonjë dokumenti në çfarëdo forme të shkruar.

c) Skema e klasifikimit

Neni 25 i Udhëzimit Administrativ 2006/03 përcakton obligimin e institucioneve për të klasifikuar dokumentet sipas një skeme të kriteriumeve për klasifikim. Mirëpo, ky udhëzim administrativ nuk iu referohet dispozitave relevante të ligjit sipas të cilëve qeveria duhet të lëshojë legjislacion plotësues ku përcaktohen rregullat dhe procedurat lidhur me klasifikimin e dokumenteve të ndjeshme.⁴³

Situata në kohën kur është kryer vlerësimi tregon se klasifikimi i dokumenteve zyrtare është kryer në pesë komuna.⁴⁴ Dy prej tyre kanë cekur se i kanë klasifikuar dokumentet sipas kriteriumeve të ndjeshmërisë.⁴⁵ Mirëpo, shumica e komunave kanë raportuar se nuk i kanë klasifikuar dokumentet e tyre zyrtare duke arsyetuar këtë me dispozitat e paqarta ligjore mbi klasifikimin e dokumenteve dhe mungesës së udhëzimeve nga niveli qendror. Lidhur me mungesën e udhëzimeve, pesë komuna kanë deklaruar se presin qartësime nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.⁴⁶ Sa i përket skemës së klasifikimit, me përjashtim të dy komunave,⁴⁷ të gjitha komunat tjera kanë deklaruar se nuk janë në dijeni për një skemë të tillë. Në mungesë të një skeme të tillë, një komunë ka deklaruar se të vetmet dokumente të cilat momentalisht konsiderohen si të ndjeshme dhe prandaj nuk janë në dispozicion të qytetarëve janë dokumentet e ndërlidhura me çështjet e personelit.⁴⁸ Për më tepër, një komunë deklaroi se, në mungesë të klasifikimit të dokumenteve sipas kriteriumeve të ndjeshmërisë, të gjitha dokumentet zyrtare në këtë komunë janë në dispozicion për qytetarët.⁴⁹

Gjatë përgatitjes së këtij raporti, Zyrja e Kryeministrit ka lëshuar një Udhëzim Administrativ 07/2007 mbi Parimet, Procedurat dhe Shenjat e Klasifikimit të Dokumenteve Zyrtare.⁵⁰ UA përcakton parimet dhe procedurat për klasifikim. Përveç kësaj, udhëzimi administrativ përmban edhe një Listë Orientuese për Dokumentet Zyrtare e cila duhet të shërbejë si bazë për klasifikimin e dokumenteve që mbahen nga institucionet përkatëse. Pritet se gjendja rreth klasifikimit të dokumenteve zyrtare siç

⁴² Suha Rekë.

⁴³ Neni 14.3 i ligjit.

⁴⁴ Vlerësimi është kryer prej 21 majit deri me 13 qershor me një vlerësim plotësues në muajin gusht 2007.

⁴⁵ Klinë dhe Vushtrri.

⁴⁶ Skenderaj, Obiliq, Prishtinë, Kaçanik dhe Viti.

⁴⁷ Klinë dhe Zveçan.

⁴⁸ Novobërdë.

⁴⁹ Gjilan.

⁵⁰ Udhëzimi Administrativ 07/2007 mbi Parimet, Procedurat dhe Shenjat e Klasifikimit të Dokumenteve Zyrtare është lëshuar më 06 qershor 2007.

është përshkruar më lartë, do të ndryshojë në mënyrë domethënëse tani me lëshimin e këtij akti nën-ligjor nga Qeveria, me të cilin është plotësuar një zbrazëturë lidhur me klasifikimin e dokumenteve zyrtare.

d) Komunikimi me banorët

Udhëzimi Administrativ 2006/03 përcakton obligime për institucionet që të hapin një adresë të përbashkët elektronike për çdo departament e cila do të shërbejë për të komunikuar me qytetarët.⁵¹

Vlerësimi ka treguar se, edhe pse vetëm një komunë ia doli të hap një e-mail të përbashkët ashtu siç parashikohet nga dispozitat gjegjëse të udhëzimit administrativ, të tjerët kanë gjetur forma alternative të komunikimit me qytetarët. Tetë komuna⁵² raportuan se kanë krijuar një farë sistemi të komunikimit me anë të postës elektronike. Në mesin e tyre, një komunë ka plotësuar obligimin ashtu siç është parashikuar me udhëzimin administrativ duke krijuar adresa të përbashkëta elektronike për çdo departament komunal.⁵³ Një mënyrë tjetër e komunikimit që është përmendur nga zyrtarët komunal është krijimi i adresës së përbashkët të e-mailit prej ku kërkesat u drejtohen departamenteve relevante.⁵⁴ Si një shembull tjetër, një komunë ka deklaruar se qytetarëve u ofrohet mundësia të shfrytëzojnë e-mail adresat private të drejtorëve të cilat mund të shihen në ueb-faqen e komunës.⁵⁵ Në një rast tjetër, një adresë e përbashkët e e-mailit ekziston por është hapur në emër të çdo drejtori të drejtoratit.⁵⁶

3. Plani i Veprimit për implementimin e Udhëzimit Administrativ 2006/03

a) Vetëdijesimi

Plani i Veprimit për implementimin e Udhëzimit Administrativ 2006/03 është lëshuar nga Ministria e Shërbimeve Publike në vitin 2006. Plani parasheh detyra specifike si për nivelin qendror ashtu edhe për atë lokal. Këtu po ashtu përfshihen korniza kohore për përmbushjen e këtyre detyrave nga institucionet gjegjëse, si pjesë e procesit të implementimit të Udhëzimit Administrativ 2006/03. Bazuar në këtë vlerësim, duket se shumë komuna kurrë nuk e kanë parë këtë dokument dhe as nuk janë njoftuar zyrtarisht për të. Gjithsej, 18 komuna konfirmuan se janë njoftuar me Planin e Veprimit ndërsa të tjerët kanë deklaruar se nuk janë në dijeni për këtë. Për më tepër, në disa komuna informata mbi ekzistimin e planit i është kufizuar vetëm te disa zyrtarë komunal. Në një komunë, sekretari i komunës, zyrtari komunal për informim si dhe këshilltari ligjor kanë deklaruar se e kanë parë dokumentin për herë të parë kur u është prezantuar nga OSBE-ja.⁵⁷

b) Aktivitetet e ndërmarra

Plani i Veprimit parasheh disa aktivitete të cilat duhet të ndërmerren nga komunat në proces të implementimit të ligjit. Disa prej aktiviteteve janë: klasifikimi i dokumenteve në përdorim; informimi i punëtorëve mbi procedurat e përdorimit të

⁵¹ Neni 41.3.

⁵² Junik, Istog, Mitrovicë, Gjakovë, Malishevë, Ferizaj, Lipjan dhe Shtime.

⁵³ Mitrovicë.

⁵⁴ Shtime dhe Lipjan.

⁵⁵ Dragash.

⁵⁶ Ferizaj.

⁵⁷ Istog.

dokumenteve zyrtare; përpilimi i raporteve vjetore, krijimi dhe zhvillimi i procedurave mbi qasjen, përdorimin dhe ruajtjen e dokumenteve zyrtare. Në këtë aspekt, katër komuna⁵⁸ kanë konfirmuar se kanë ndërmarrë disa aktivitete të parashikuara me Planin e Veprimit. Për shembull, komuna e Dragashit ka ndërmarrë aktivitete lidhur me përgatitjen dhe miratimin e listës së dokumenteve të ndjeshme, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e dokumenteve zyrtare, parashtrimin e raporteve vjetore si dhe përpilimin e regjistrit. Përkundër kësaj, 29 komuna⁵⁹ kanë deklaruar se nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim të parashikuar me Planin e Veprimit. Zyrtarët komunal i kanë përmendur arsyet e caktuara për mos-kryerjen e këtyre aktiviteteve siç është mungesa e bashkëpunimit me Institucionet e Përkohëshme për Vetëqeverisje⁶⁰ ose mungesën e udhëzimeve nga niveli qendror.⁶¹

c) Lista e dokumenteve të ndjeshme komunale

Njëri prej aktiviteteve të paraparë në Planin e Veprimit është krijimi i një liste të dokumenteve të ndjeshme dhe një skeme të përgjithshme referimi e cila duhet t'i parashtrohet Komisionit Ndër-institucional për harmonizim.⁶² Lidhur me klasifikimin e dokumenteve dhe çështjeve të ndërlidhura, duket se mungesa e dispozitave të qarta ligjore ishte arsyeja kryesore që klasifikimi i dokumenteve të ndjeshme nuk është harmonizuar ende.

Në bazë të përgjegjeve të ofruara, 31 komuna kanë deklaruar se nuk i kanë parashtruar Komisionit Ndër-institucional listën e dokumenteve të ndjeshme dhe skemën e dokumenteve zyrtare. Dy komunitat e tjera deklaruan se janë në proces të përpilimit të listës.⁶³ Në disa raste, zyrtarët komunal kanë përmendur arsye për mos përpilimin e listës. Dy kanë përmendur shprehimisht se nuk janë në dijeni për Komisionin Ndër-institucional dhe as nuk janë njoftuar asnjëherë nga Komiteti për ndonjë kërkesë të tillë.⁶⁴ Për më tepër, mungesa e udhëzimeve nga niveli qendror dhe ekzistimi i një numri të vogël të dokumenteve të ndjeshme komunale,⁶⁵ janë dhënë si arsye për mos parashtrimin e listës së dokumenteve të ndjeshme.

Përkundër kësaj, udhëzimi administrativ i paradokohshëm 07/2007 mbi klasifikimin e dokumenteve zyrtare e cila është miratuar nga Zyrja e Kryeministrit, rregullon në hollësi procesin e përgatitjes së listës së dokumenteve zyrtare. Udhëzimi Administrativ parasheh krijimin e Komisionit për klasifikimin e dokumenteve në kuadër të çdo institucioni, i cili është përgjegjës për përpilimin e listës së tillë.⁶⁶ Për

⁵⁸ Mitrovicë, Junik.

⁵⁹ Në mesin e këtij numri, katër komuna u janë referuar aktiviteteve që janë ndërmarrë në përputhje me Planin Komunal për Transparencë e cila është parashikuar me Udhëzimin Administrativ 2006/03 mbi Transparencën Komunale, të lëshuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal..

⁶⁰ Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq. Duhet të ceket se dy të parat kanë theksuar se momentalisht janë duke i bojkotuar Institucionet e Përkohëshme të Vetëqeverisjes.

⁶¹ Skenderaj.

⁶² Komisioni Ndër-institucional (Komisioni) është themeluar më 17 maj 2006. Themelimi dhe funksionimi i Komisionit parashihet në Nenin 14.2 të ligjit, ndërsa struktura e tij përcaktohet me Nenin 20 të Udhëzimit Administrativ 2006/03. Komiteti shqyrton praktikën më të mira dhe i shtjellon konfliktet e mundshme në procesin e implementimit të Ligjit. Komisioni përbëhet nga tetë anëtarë të cilët janë emëruar nga Qeveria dhe nga Kryesuesi i Komisionit po ashtu i emëruar nga Qeveria.

⁶³ Podujevë dhe Shtime.

⁶⁴ Fushë Kosovë dhe Gjakovë.

⁶⁵ Zubin Potok dhe Kamenicë.

⁶⁶ Neni 3 i UA 07/2007.

më tepër, udhëzimi administrativ përcakton se pas aprovimit nga Komisioni brenda institucionit përkatës, lista e dokumenteve të ndjeshme i parashtrohet Komisionit Ndër-institucional.⁶⁷

Vlerësimi ka dëshmuar se shumica e komunave as nuk janë të informuara dhe as nuk kanë pranuar ndonjë kopje të Udhëzimit Administrativ 07/2007. Prej 33 komunave, 30 kanë raportuar se nuk kanë pranuar Udhëzimi Administrativ 07/2007 ndërsa vetëm katër komuna janë të informuara për këtë. Për më tepër, vetëm tri komuna⁶⁸ kanë themeluar Komisione për klasifikimin e dokumenteve zyrtare, ndërsa njëra pohon t'ia ketë parashtruar listën Komisionit Ndër-institucional.⁶⁹

Sipas njërit prej anëtarëve të Komisionit Ndër-institucional,⁷⁰ deri më sot, ata nuk kanë pranuar asnjë listë të dokumenteve të ndjeshme në pronësi të institucioneve, edhe pse afati për parashtrimin e listave të tilla ka skaduar.⁷¹ Njëra prej arsyeve për vonesë të tillë mund të jetë mungesa e bashkëpunimit ndërmjet nivelit qendror dhe institucioneve ku ai beson se në shumë raste institucionet madje as nuk janë të vetëdijshme për Udhëzimi Administrativ 07/2007. Në anën tjetër, bashkëpunimi i tillë ndërmjet Komisionit Ndër-institucional dhe institucioneve mungon, dhe nuk ka sistem të komunikimit të themeluar ndërmjet tyre. Lidhur me çështjen e klasifikimit, anëtarët e Komisionit Ndër-institucional po ashtu përmenden nevojat e trajnimit mbi klasifikimin e dokumenteve zyrtare ashtu siç parashihet me këtë udhëzim administrativ. Në këtë aspekt, anëtarët e këtij Komisionit të cilët kanë marrë pjesë në përpilimin e udhëzimit administrativ do të ishin të gatshëm të ofrojnë trajnime për zyrtarët në institucione.

d) Shembuj të dokumenteve të ndjeshme komunale

Nga 33 komuna, 25 i kanë ofruar shembujt e tyre që besojnë se janë dokumente të ndjeshme në komunat e tyre. Në tri raste zyrtarët komunal deklaruan se nuk janë në gjendje të ofrojnë shembujt të tillë,⁷² për tri komuna përgjegjja ishte që kjo pyetje nuk vlen për ta,⁷³ ndërsa në dy komuna të tjera zyrtarët kanë deklaruar se nuk posedojnë dokumente të ndjeshme.⁷⁴ Zyrtarët komunal u janë referuar dokumenteve të ndryshme të cilat ata i konsiderojnë si dokumente të natyrës së ndjeshme.⁷⁵ Dokumentet që më së shpeshti përmenden si të ndjeshme nga zyrtarët komunal ishin dosjet/shënimet personale. Në një përgjegje interesante, një komunë, përmendi dokumentet siç janë

⁶⁷ Neni 7 i Udhëzimit Administrativ 07/2007.

⁶⁸ Prishtinë, Shtime dhe Viti.

⁶⁹ Shtime.

⁷⁰ Më 10 shtator 2007, OSBE-ja ka mbajtur një takim me një anëtar të Komitetit ndër-institucional.

⁷¹ Neni 7 i Udhëzimit Administrativ AI 07/2007 parasheh afatin prej 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativit përbrenda të cilit institucionet janë të obliguara të parashtrorjnë listën e dokumenteve të ndjeshme Komisionit Ndër-institucional.

⁷² Podujevë, Shtime dhe Mitrovicë.

⁷³ Gjilan, Kaçanik dhe Junik.

⁷⁴ Glllogoc dhe Leposaviq.

⁷⁵ Zyrtarët komunal në komuna të ndryshme kanë përmendur dokumente vijuese si dokumente që përmbajnë informata të ndjeshme: ofertat e tenderëve; informatat mbi të dhënat kadastrale; dokumentet mbi regjistrimin civil; fletë notimet nga intervistat; informatat mbi birësimin e fëmijëve; masat disiplinore; planet e veprimet për raste emergjente; dokumente specifike financiare; procesverbalet nga takimet e sigurisë; rezultatet e votimit nga regrutimi i drejtorëve; statutin e shërbimit civil; informatat mbi viruset/pandemitë; informatat mbi shumën e alokuar për një projekt dhe informata mbi procedurat gjyqësore në zhvillim e sipër ku komuna është një palë e procedurës.

regjistri i personave që posedojnë armë,⁷⁶ lista e banorëve që i kanë marrë lejet për ngasje të automjeteve gjatë luftës në Kosovë dhe informatat e ndërlidhura me tokën private të nacionalizuar pas Luftës së Dytë Botërore,⁷⁷ si dokumente shumë të ndjeshme. Shembuj të dokumenteve të ndjeshme të përmendura nga zyrtarët komunal tregojnë se të kuptuarit e asaj që konsiderohet si dokument zyrtar i ndjeshëm është mjaft i larmishëm.

OSBE-ja beson se mungesa e udhëzimeve të qarta është arsyeja për këtë shumëllojshmëri të shembujve të përmendur si dokumente të ndjeshme sipas zyrtarëve komunal. Përkundër kësaj, kjo situatë pritet të ndryshojë me udhëzimit administrativ të lëshuar para do kohe me qartësime për klasifikimin e dokumenteve, i cili ndër çështje të tjera jep edhe një listë orientimi të klasifikimit të dokumenteve zyrtare. Lista orientuese përfshin sfera të ndryshme dhe për çdo sferë cek disa dokumente që i takojnë asaj sferë. Institucionet duhet të bëjnë klasifikimin e dokumenteve zyrtare në bazë të kësaj liste. Me miratimin e këtij akti nën-ligjor, po ashtu pritet të vihet në zbatim një njëtrajtshmëri në procesin e klasifikimit të dokumenteve zyrtare.

D. Aktivitetet e trajnimit/të ngritjes së vetëdijes

Ky kapitull do të përqendrohet në aktivitetet e trajnimit të ndërlidhura me ligjin-në dhe legjislationin përcjellës, që mbahen në nivelin lokal. Informatat mbi aktivitetet e trajnimit dhe të ngritjes së vetëdijes të organizuar nga Institucionet e Përkohëshme të Vetëqeverisjes dhe nga OSBE-ja, po ashtu përfshihen në këtë kapitull.

1) Trajnimi/Instituti Kosovar për Administratë Publike

Rregullorja e UNMIK-ut 2005/15 me të cilën ndryshohet Rregullorja e UNMIK-ut 2001/19 mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetë-qeverisjes në Kosovë, përcakton se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kryen funksione në sferën e administratës lokale përfshirë identifikimin e mënyrave dhe mjeteve për kryerjen e aktiviteteve të trajnimit për komunat.⁷⁸ Rregullorja obligon Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal t'u ndihmojë komunave që t'i bëjnë aktivitetet e tyre sa më transparente për popullatën.⁷⁹ Për më tepër, Udhëzimi Administrativ 2003/25⁸⁰ me të cilin themelohet Instituti Kosovar për Administratë Publike si Agjencion Ekzekutiv i Ministrisë për Shërbime Publike, parasheh që ky institucion t'i përmirësojë kushtet për trajnimin e shërbyesve civil në përputhje me standardet evropiane të administratës publike.

Shumica e komunave dhe pilot njësisive komunale raportuan se kanë vijuar seanca trajnimi mbi ligjin, ndërsa zyrtarët komunal në gjashtë komuna deklaruan se nuk u

⁷⁶ Në shpjegimet e tyre, zyrtarët komunal kanë deklaruar se dokumentet janë të ndjeshme sepse “gjatë luftës vetëm ata që kanë bashkëpunuar me regjimin serb kishin të drejtë të mbanin armë dhe shpaloja e kësaj liste do të mund t'i vinte në rrezik këta banorë”.

⁷⁷ Sa për këto dokumente, zyrtarët komunal kanë deklaruar se informatat do të ishin të ndjeshme sepse disa pronarë të tokave janë kompensuar ndërsa të tjerët jo.

⁷⁸ Rregullorja e UNMIK-ut 2005/15, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetë-qeverisjes në Kosovë. Shtojca XIV, (iii) (e).

⁷⁹ Rregullorja e UNMIK-ut 2005/15, Shtojca XIV, (iii) (f).

⁸⁰ Implementimi i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/19 mbi Degën Ekzekutive të Insitucioneve të Përkohëshme për Vetëqeverisje në Kosovë.

është ofruar trajnimi.⁸¹ Zakonisht, trajnimet organizohen nga Instituti Kosovar për Administratë Publike . Më së shpeshti, një apo dy zyrtarë komunal kanë marrë pjesë në trajnim. KE, drejtorët e administratave, zyrtarët komunal për informim dhe zyrtarët për çështje ligjore zakonisht ishin përfitues të trajnimeve, ndërsa në komunën e Skenderajt gati të gjithë zyrtarët komunal raportuan të kenë marrë trajnim. Në disa seanca, çështja e qasjes në dokumente zyrtare është mbuluar si pjesë e ndonjë teme më të gjerë trajnimi mbi transparencën komunale, siç ishte trajnimi i Ministrisë për Shërbimeve Publike brenda të cilit është trajtuar edhe ligji mbi qasje në dokumente zyrtare,⁸² ose si komponentë në disa trajnime profesionale të organizuara nga Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara, dhe Instituti Kosovar i Arkivave.⁸³ Ministria e Shërbimeve Publike , përveç përpilimit të Doracakut mbi ligjin, po ashtu ka organizuar disa trajnime për zyrtarë në nivel qendror dhe lokal.

Disa zyrtarë komunal dhe të pilot njësive komunale theksuan se do të ishte e dobishme që trajnimi mbi ligjin të vazhdojë, dhe se këto trajnime duhet të përfshijnë të gjithë shërbyesit civil komunal në mënyrë që të rritet njohuria interne mbi këtë çështje.⁸⁴ Në këtë drejtim, OSBE-ja po ashtu ka qenë e kyçur në aktivitete për ngritjen e vetëdijes mbi këtë Ligj, si dhe procedurën për qasje dokumenteve zyrtare sipas këtij ligji. Në fillim të këtij viti, OSBE-ja ka implementuar projektin “Transparenca Komunale” në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe me Ministrinë për Shërbime Publike. Pikësynimi i përgjithshëm i projektit ishte të avancojë dhe të rris transparencën e administratës komunale, ndërsa një prej pikësnyimeve më specifike ishte lehtësimi i zbatimit të akteve normative lidhur me politikën e transparencës lokale përfshirë këtu edhe implementimin e ligjit dhe akteve nën-ligjore. Përveç kësaj, OSBE-ja, përmes ekipeve komunale të saj, është rregullisht e kyçur në organizimin e aktiviteteve në komuna me qëllim të rritjes së vetëdijes mbi këtë ligj në mesin e zyrtarëve komunal dhe qytetarëve.⁸⁵

2) Doracaku i MSHP-së mbi Ligjin

Edhe pse disa zyrtarë komunal kanë marrë trajnime mbi ligjin, gjysma e komunave nuk kanë marrë kopje të Doracakut mbi ligjin-në të përgatitur nga Ministria e Shërbimeve Publike në vitin 2006.⁸⁶ Doracaku u dedikohet qytetarëve, gazetarëve dhe institucioneve si një referencë e shpejtë e cila shpjegon disa probleme më të shpeshta të ndërlidhura me qasjen në dokumente zyrtare. Shpjegimet janë dhënë në doracak bazuar në ligjin dhe Udhëzimin Administrativ 2006/03. Disa kopje të këtij Doracaku janë dhënë gjatë trajnimeve të IKAP-it, ndërsa në disa raste zyrtarët komunal kanë marrë kopje përmes Ministrisë së Shërbimeve Publike. Vetëm një komunë raportoi shpërndarje më të gjerë të doracakut në mesin e zyrtarëve komunal.⁸⁷ Në përgjithësi,

⁸¹ Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq, Vushtrri, Kaçanik, Shtërpçë, Suharekë, Pejë dhe Klinë.

⁸² Novobërdë.

⁸³ Viti.

⁸⁴ Prishtinë, Kamenicë, Gjakovë dhe Klinë.

⁸⁵ Për shembull, Ekipet Komunale në pilot njësinë komunale Mamushë kohë më parë ka organizuar një takim informativ për zyrtarët komunal dhe anëtarët e bashkësisë ku EK u sqaruan atyre thelbin e provizioneve kryesore ligjore sa i përket qasjes së dokumenteve zyrtare. Poashtu, EK në Novobërdë do ta përkrahë publikimin e doracakut që shpreh atë se çfarë mund të presin qytetarët nga Plani Komunal i Veprimit Transparent, me theks të veçantë mbi ligjin.

⁸⁶ Doracaku si duket nuk është dërguar në komunat në vijim: Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq, Vushtrri, Novobërdë, Ferizaj, Hani i Elezit, Kaçanik, Shtërpçë, Prizren, Malishevë, Mamushë, Pejë, Istog dhe Klinë

⁸⁷ Skenderaj.

komunat janë në dijeni për ekzistimin e doracakut, edhe pse qëllimi i tij është ta lehtësojë zbatimin e ligjit në nivel qendror dhe lokal.

3) Aktivitetet komunale për ngritje të vetëdijes mbi ligjin

Aktivitetet për ngritjen e vetëdijes në përgjithësi synojnë të inkurajojnë pjesëmarrjen e banorëve/qytetarëve dhe të kuptuarit e një çështjeje. Aktivitetet e tilla zakonisht prezantojnë një temë e cila është e re apo që nuk kuptohet sa duhet në mesin e anëtarëve të bashkësisë. Ngritja e vetëdijes nënkupton një qasje pro aktive për anën e cila ka interes në rritjen e gatishmërisë në një temë të caktuar. Ligji mbikëqyr obligimin e institucioneve për të informuar institucionet për të informuar popullatën mbi të drejtat të cilat i gëzojnë sipas Ligjit.⁸⁸

Një numër i vogël i komunave kanë bërë përpjekje individuale për ta ngritur vetëdijen mbi ligjin. Në komunën e Mitrovicës, janë mbajtur disa debate me shoqërinë civile përmes Zyrtarit Komunal për Informim. Në Obiliq, janë shpërndarë broshura dhe banorët mund t'i sigurojnë edhe në hyrje të ndërtesës komunale. Në Shtime, kohët e fundit është organizuar një debat publik me banorët dhe me shoqërinë civile, ku ligji mbi qasje në dokumente zyrtare ishte njëra prej temave kryesore. Në Gjilan, vetëdijesimi intern i shërbyesve civil është rritur duke i informuar ata për formularët e Ministrisë së Shërbimeve Publike për qasje dokumenteve zyrtare dhe duke i informuar banorët përmes ueb-faqes për të drejtën e tyre në qasje në dokumente zyrtare. Në Malishevë, në bashkëpunim me OSBE-në, komuna ka organizuar një tryezë të rrumbullakët dhe ka shpërndarë posterë për të promovuar ligjin. Tryeza e rrumbullakët është përcjellë nga një numër i emisioneve televizive të cilat janë përqendruar posaçërisht në këtë ligj. Në Klinë, Rregullorja Komunale mbi Konsultimin dhe Pjesëmarrjen Publike në Vendim-marrje përfshin dispozitat relevante nga ky ligj lidhur me qasjen në dokumentet zyrtare, mënyrën e qasjes në dokumentet zyrtare në komunë, afatet kohore për ofrimin e informatave të kërkuara si dhe dispozitat mbi mjetet juridike.⁸⁹ Në Dragash, komuna ka përgatitur posterë dhe fletëpalosëse mbi të drejtën e qasjes në informim. Disa komuna, megjithatë, kanë raportuar se nuk kanë organizuar kurrfarë aktiviteti specifik për ngritjen e vetëdijes mbi ligjin. Disa e kanë shtjelluar këtë çështje si pjesë e diskutimeve publike në kuadër të planit të veprimit për transparencë komunale.⁹⁰

Aktivitetet në ngritjen e vetëdijes janë mbajtur po ashtu në shoqërinë civile. Në këtë aspekt, organizata jo-qeveritare regionale Iniciativa Rinore për të Drejtat e Njeriut është për t'u veçuar. Ajo ka monitoruar zbatimin e ligjit mbi qasje në dokumente zyrtare dhe i ka publikuar rezultatet në një raport të publikuar në janar 2007.⁹¹

E. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

Ky kapitull ofron një pasqyrë mbi numrin e kërkesave për qasje në dokumente zyrtare që i janë parashtruar komunave. Gjendja faktike përkitazi me krijimin e bazës së të

⁸⁸ Neni 13 (a) i ligjit.

⁸⁹ Rregullorja Komunale mbi Konsultimin dhe Pjesëmarrjen e Publikut në Vendim-marrje, Pjesa III, E drejta e publikut në informim dhe qasje dokumenteve komunale, Neni 16, 17 dhe 18.

⁹⁰ Podujevë, Lipjan, Glogoc, Novobërdë, Prizren, Pejë dhe Junik.

⁹¹ Prej 30 komunave të cilave Iniciativa Rinore për të Drejtat e Njeriut ka dërguar kërkesë për qasje në dokumentet zyrtare, 13 nuk janë përgjigjur fare. Shih raportin e Initiatives : Monitorimi i Ligjit për Qasje në Dokumentet Zyrtare, janar 2007, Prishtinë.

dhënave mbi numrin e kërkesave që u janë parashtruar komunave po ashtu është e dhënë këtu.

1) Numri i kërkesave të pranuar/qasjes së lejuar apo të refuzuar

Tabela vijuese jep numrin e kërkesave të parashtruara, numrin e rasteve ku qasja është lejuar apo refuzuar sipas zyrtarëve komunal të intervistuar nga Ekipet Komunale . Vlerësimi mbulon periudhën ndërmjet viteve 2006 dhe 2007 dhe përfshin 30 komuna dhe tre pilot njësi komunale në Kosovë.

	Numri i kërkesave të pranuar	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar
Novobërdë	80	79	1
Kaçanik	63	63	0
Viti	20	20	0
Prishtinë	18	18	0
Kamenicë	13 (2 në procedurë)	11	0
Rahovec	7	7	0
Klinë	6	6	0
Mitrovicë	6	6	0
Suharekë	4	4	0
Prizren	3	3	0
Lipjan	3	3	0
Ferizaj	2	2	0
Fushë Kosovë	2	2	0
Pejë	2	1	1
Dragash	1	1	0
Obiliq	1	1	0
Shtime	1	1	0
Gjilan	1	1	0
Istog	1	1	0
Skenderaj	1	1	0
Vushtrri	1	1	0
Malishevë	0	0	0
Gjakovë	0	0	0
Shtërpcë	0	0	0
Podujevë	0	0	0
Mamushë	0	0	0
Hani i Elezit	0	0	0
Junik	0	0	0
Deçan	0	0	0
Leposavic	0	0	0
Zveçan	0	0	0
Zubin Potok	0	0	0
Gllgoc	Nuk ka përgjigje	Nuk ka përgjigje	Nuk ka përgjigje

Kjo tabelë jep një pasqyrë të informatave të pranuar nga zyrtarët komunal. Pasi që nuk janë regjistruar të gjitha kërkesat e Iniciativës Rinore për të Drejtat e Njeriut (shih shënimin 91 në fund të faqës), dyshohet se të intervistuarit janë plotësisht të saktë në shënimet e tyre.

2) Baza e të dhënave mbi numrin e kërkesave

Gati gjysma e komunave kanë raportuar se mbajnë të dhëna të shkruara mbi kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, dhe të dhëna në rastet kur kërkesa është miratuar apo refuzuar.⁹² Mirëpo, asnjë komunë nuk ka raportuar mbi krijimin e ndonjë baze

⁹² Prishtinë, Fushë Kosovë, Podujevë, Lipjan, Shtime, Gjilan, Kamenicë, Kaçanik, Rahovec, Pejë, Istog, Klinë dhe Mitrovicë.

specifike të të dhënave mbi kërkesat për qasje në dokumentet zyrtare. Për komunat e pakta që mbajnë shënime të shkruara mbi kërkesat e parashtruara, zakonisht zyra e arkivës ose zyra e pranimit janë përgjegjëse për të mbajtur të dhëna mbi kërkesat dhe përfundimin e tyre. Shtatë komuna nuk kanë kurrfarë të dhëna mbi kërkesat, edhe pse kanë raportuar se i pranojnë kërkesat.⁹³

F. Konkluzionet

Sipas vlerësimeve tona, shumë pengesa të identifikuar në procesin e implementimit të kornizës ligjore mbi të drejtën në qasje të informatave në nivel komunal janë të përbashkëta për shumicën e komunave.

Një problem shumë i madh duket të jetë njohuria e komunave lidhur me kornizën ligjore. Edhe pse shumica e komunave dhe pilot njësive komunale janë në dijeni të ekzistimit të legjislacionit parësor, gjegjësisht ligjit mbi qasje në dokumente zyrtare, zyrtarëve komunal u mungon njohuri e qartë e ligjit primar dhe akteve nën-ligjore të lëshuara nga ministritë përkatëse dhe qeveria gjatë procesit të implementimit të ligjit

Një pengesë tjetër e identifikuar nga zyrtarët komunal është mungesa e njohurisë në mesin e qytatarëve mbi konceptet e lirisë në informim, dhe në veçanti mbi të drejtën në qasje dokumenteve zyrtare që mbahen nga institucionet. Komunat kanë përmendur dekada të administratës jo transparente ku dokumentet zyrtare nuk ishin në dispozicion, si një faktor të rëndësishëm që rezulton në numrin shumë të ulët të kërkesave për qasje dokumenteve zyrtare të parashtruara komunave përkatëse.

Mungesa e njohurive lidhur me dispozitat e ligjit e kombinuar me mungesën e gatishmërisë për të implementuar Ligjin kanë rezultuar në mosrespektimin e dispozitave gjegjëse të këtij ligji nga ana e komunave. Për shembull, në një numër të madh rastesh komunat nuk kanë përpiluar regjistra të dokumenteve zyrtare ndërsa pengesë kryesore për këtë duket të jetë mungesa e interesimit për të përmbushur dispozitat përkatëse të ligjit. Sa i përket çështjes së raportimit vjetor, zyrtarët shpesh kanë deklaruar se për shkak të numrit të vogël të kërkesave për qasje në dokumente zyrtare, ose në disa raste për shkak të faktit se nuk ka pasur kërkesa të parashtruara, ata besojnë se përpilimi i raportit vjetor është i panevojshëm. Mirëpo, sipas interpretimit të ligjit nga ana e OSBE-së, këto raporte kanë për qëllim po ashtu monitorimin dhe implementimin e ligjit nga institucionet relevante dhe këto duhet të lëshohen pa marrë parasysh numrin e kërkesave të parashtruara nga banorët.

Mungesa e zyrtarëve të emëruar komunal – gjegjësisht arkivistit – për shtjellimin e kërkesave, mungesa e udhëzimeve të qarta lidhur me çështjen e skemës së klasifikimit dhe vetë klasifikimit të dokumenteve zyrtare, po ashtu janë përmendur si probleme të mëdha në të cilat është hasur gjatë implementimit të ligjit në nivel komunal.

Edhe një çështje tjetër që shpesh është përmendur nga zyrtarët komunal është mungesa e bashkëpunimit ndërmjet nivelit qendror dhe lokal si dhe mungesa e udhëzimeve të qarta nga niveli qendror. Lidhur me bashkëpunimin, komunat po ashtu i janë referuar rrjedhës së informatave ndërmjet drejtorateve komunale e cila duket të jetë e pamjaftueshme kur është fjala për zbatimin e këtij ligji. Si pasojë, në shumë

⁹³ Glllogoc, Ferizaj, Viti, Suharekë, Leposaviq, Zubin Potok, dhe Skenderaj.

raste vetëm zyrtarë të lartë të komunave janë në dijeni për zhvillimet në sferën e zbatimit të këtij Ligji.

Informatat në nivel lokal, lidhur me zhvillimet në procesin e implementimit të Ligjit duket po ashtu se janë problematike. Shumë komuna nuk e kanë pranuar Planin e Veprimit të Ministria e Shërbimeve Publike mbi implementimin e Udhëzimit Administrativ 2006/03. Rrjedhimisht, më shumë se gjysma e komunave nuk kanë përgatitur lista të dokumenteve të ndjeshme ose nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim të parashikuar me Planin e Veprimit.

Në fund, gati të gjitha komunat dhe pilot njësisit komunale kanë theksuar nevojën për trajnime të mëtejme profesionale që do të përqendroheshin posaçërisht në personelin komunal i cili merret me zbatimin e ligjit mbi qasje në dokumente zyrtare.

G. Rekomandimet

Për ta përmirësuar implementimin e këtij ligji dhe për ta arritur transparencën komunale duke u mundësuar qytetarëve qasje në dokumentet zyrtare, komunat dhe ministritë relevante duhet të vazhdojnë me implementimin e ligjit në fuqi duke shqyrtuar njëkohësisht çështjet e identifikuar. Në këtë aspekt, OSBE-ja rekomandon si në vijim:

Rekomandimet për komunat

- Komunat duhet të vazhdojnë me aktivitetet për rritjen e vetëdijes përmes fushatave të informimit që do të kenë si cak zyrtarët dhe banorët komunal.
- Komunat duhet të krijojnë regjistrin e të gjithë dokumenteve zyrtare, që mbahen ose që janë në pronësi të komunës.
- Komunat duhet të mbajnë shënime të shkruara lidhur me kërkesat e parashtruara dhe të lëshojnë raporte vjetore në përputhje me ligjin në fuqi.
- Komunat duhet të emërojnë dhe të caktojnë një zyrtar komunal/arkivist i cili do të merret me kërkesat për qasje në dokumente zyrtare.
- Komunat duhet të vazhdojnë me përmbushjen e detyrave të tyre ashtu siç është parashikuar me Planin e Veprimit.
- Çdo komunë duhet të themelojë një komision për përpilimin e listës së dokumenteve të ndjeshme dhe t'i parashtrorjë listën Komisionit Ndër-institucional.

Rekomandimet për Institucionet e Përkoshme të Vetëqevrisjes

- Ministria a Administrimit Lokal Publik dhe Ministria e Shërbimeve Publike përmes Institucionit Kosovar për Administrim Publik, duhet të vazhdojnë me

trajnim dhe ngritje të kapaciteteve të zyrtarëve komunal në tërë kornizën ligjore që rregullon çështjen e qasjes në dokumentet zyrtare.

- Aktivitetet e trajnimit për zyrtarët komunal të organizuar nga niveli qendror, duhet të përqendrohen veçanërisht në procedurat që duhet të zbatohen në sigurimin e qasjes në dokumentet zyrtare. Arkivistët duhet të përfshihen në grupin cak, pasi që ata merren me shtjellimin e kërkesave. Trajnimet po ashtu duhet të vejnë një theks të veçantë në klasifikimin e dokumenteve sipas Udhëzimi Administrativ 07/2007.
- Niveli qendror duhet të ofrojë udhëzime të qarta mbi çështjen e implementimit të këtij ligji dhe të njoftojë rregullisht komunat mbi zhvillimet që kanë të bëjnë me procesin e implementimit.
- Ministria e Shërbimeve Publike duhet të përkujdeset që të gjitha komunat të informohen për Planin e Veprimit dhe i njejtë duhet të ju distribuohet.
- Zyrja e Kryeministrit duhet të përkujdeset që komunat të jenë të informuara dhe të pajisura me Udhëzimin Administrativ 07/2007 mbi Parimet, Procedurat dhe Shenjat e Klasifikimit të Dokumenteve Zyrtare.

Rekomandimet për Komisionin Ndër-institucional

- Komisioni Ndër-institucional duhet të përcaktojë sistem të kontakteve dhe të komunikimit me të gjithë 30 komunat dhe në tre pilot njësit komunale.
- Komisioni Ndër-institucional duhet të sigurojë trajnime, përmes Institucioni Kosovar për Adminstrim Publik, për zyrtarët në çështjen e klasifikimit të dokumenteve të ndjeshme sipas Udhëzimit Administrativ 07/2007.